Tirane, 31 Mars 1939

ΠΑΝΕΠΙΣΤΗΜΙΟ ΙΩΑΝΝΙΝΩΝ
ΑΡΧΕΙΟ ΕΥΛΟΓΙΟΥ ΚΟΥΡΙΛΑ
Αρ. Εγγρ.: 1.1(43)

Fort i nderuar im Zengj,

Besonj se arrijte mirë atë ditë në Kendrën t'uaj dhe uronj të rregullohi dhe të shkoni në paqe e qetësi. Me ardhi keq se nuk ju arriva që t'ju uronjâ udhën e mbarë, gjer sa u-kthe-va nga shtëpia e Kryeministrit, ku vajta me këmbë për të kër-kuar zarfin t'uaj dhe u-kthe-va me karrocë, po kishit nisur. Atje kërkuan përsëri dhe me nxua-rrë një listë të votimeve ~~të~~ Dhimogjerondis dhe unë e mora se kujtova që do t'ish nga ~~ato~~ shkresa. Po njëkohësisht dhashë lajmërimin në gazetën "Shtypi" dhe dje m'a solli zarfin një djal' i math, i cili e kish gjetur pranë Ministris s'Arsimit, më tha. I dhashë këtij një shpërblim (1 frangë) po gjeta belanë, se nuk u-kënaq, priste nja 5 franga!!. Sido qoftë τὸ ἀπολωλὸς εὑρέθη, dhe do t'ua dërgonj me Llambi Telin i cili

ardhi këtu dje mbrëma. Shkresat
tjatër, që më dhanë një shtëpiā
e Kryeministrit ua kë theva.

Me z. Iliā Kota do vete ~~të~~
pigem tashi në mëngjës, sa po
të hapen Zyrat, se dje vajta
një herë po ishin në mbledhje
(Komision në Ministri).

Mësova se "Οἱ ἅγιοι Συνοδικοί",
që kanë mbetur këtu vazhdu-
akan mbledhje, kishin edhe
dje mbrëma, po nuk mësova dot
se ç'bisedojnë; po të marr vesh
do t'ju shkruanj përsëri.

Gjith ashtu mësova me gëzim
se kini një [redacted] letrë-falënde-
rimi nga L.M.T. Mbreti për dhu-
ratat; m'a suallë këtu, po mbasi
u thashë që shkuatë, e muarrë
t'ua dërgojnë me postë.

Të fala të përzëmërta z.
Vasilen Kondit nga unë edhe një
familja, ashtu edhe Dhiakos.

Me kënë ju puth dorën

Nipi juaj
Vasili